



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.590/6 Prot

Tiranë, më 26.4.2023

#### VENDIM

**Nr.17, datë 26.4.2023**

#### PËR

#### URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

#### KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_, gazetare pranë “BIRN Albania”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 590 Prot., datë 15.03.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Spitali Rajonal Shkodër (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 08.02.2023, depozituar në adresën elektronike [spitalishkoder@shendetesia.gov.al](mailto:spitalishkoder@shendetesia.gov.al), ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. Sa është sasia vjetore e mbetjeve spitalore?
2. Sa është fondi në buxhetin tuaj për mbetjet spitalore?
3. Me cilën apo cilat kompani keni kontrata për mbetjet spitalore? Ju lutem, na i vini në dispozicion.
4. Sa është vlera financiare e shpenzuar nga 2019-2022 për mbetjet spitalore nga institucioni juaj?

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 521 Prot., datë 16.02.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...Sasia vjetore e mbetjeve është e lidhur ngushtësisht me aktivitetin spitalor të institucionit tonë dhe varion nga viti në vit, në varësi të kësaj përcaktohen edhe fondet në buxhetin e institucionit, në përputhje me VKM “Për financimin e shërbimeve

*shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Bazuar në legjislacionin e prokurimit publik, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, për trajtimin e mbetjeve spitalore realizohen procedura prokurimi, e kryesisht për shkak të fleksibilitetit të sasive të mbetjeve që gjenerohet çdo vit, në varësi edhe të llojeve dhe kodeve të caktuara të tyre, përdoret si mjet për realizimin e procedurës së prokurimit Marrëveshja Kuadër. Operatorët ekonomik të cilët shpallen të suksesshëm nga Marrëveshjet Kuadër procedojnë me nënshkrimin e minikontratave me AK, të dhënat e tyre i gjeni në sistemin elektronik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), sipas objektit të procedurës, në linkun: <https://www.app.gov.al/export-public-calls/>”.*

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se: “...përgjigja e vendosur në dispozicion nuk është në përputhje me kërkesën për informacion në të cilën është kërkuar konkretisht: Sa është sasia vjetore e mbetjeve spitalore? Sa është fondi në buxhetin e spitalit për mbetjet spitalore? Me cilën apo cilat kompani keni kontrata për mbetjet spitalore (kopje të tyre)? Sa është vlera financiare e shpenzuar nga 2019 – 2022 për mbetjet spitalore nga institucioni juaj?”. Ndodhur në këto kushte, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e autortetit publik për dhënien e informacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 590/1 prot., datë 17.03.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 24.03.2023.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 861/1 Prot., datë 28.03.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 590/3 Prot., datë 30.03.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...Spitali Rajonal Shkodër zbaton VKM nr. 897, datë 29.09.2010 që ka të miratuar dhe “Regulloren për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”.

*Spitali Rajonal Shkodër ka lidhur marrëveshje kuadër 2 (dy)vjeçare për vitin 2021-2023 Evadim Mbetje Urbane me fond limit 4.471.804 lekë dhe Evadim Mbetje të Rezikshme me fond limit 1.081.860 lekë.*

*Për sa i përket sasive ato janë të përcaktuara në marrëveshje kuadër të cilën e gjeni në link: <https://www.app.gov.al/export-public-calls>”.*

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja pretendon se përsëri nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar, ndaj nëpërmjet e-mail-it datë 31.03.2023 dhe datë 18.04.2023, ka vijuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar vendosjen në dispozicion të informacionit sipas objektit të kërkesës për informacion.

Në këto kushte, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se përgjigja e vendosur në dispozicion nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me kërkesën për informacion datë 08.02.2023.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*. Në kuptim të këtij parashikimi, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Spitali Rajonal Shkodër është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Për më tepër, theksojmë se, një pjesë e informacionit të kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni, që duhet të bëhet publik pa kërkesë. Çdo autoritet publik, bazuar në shkronjat e) dhe ë) të pikës 1, të nenit 7 të LDI, duhet të ketë publik në programin e transparencës - e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifrat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara; - ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:

- i. listën e kontratave të lidhura;
- ii. shumën e kontraktuar;
- iii. palët kontraktuese dhe përkrahësit e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Në lidhje me linkun e vendosur në kthim përgjigjen, në të cilën Autoriteti Publik pretendon se është publikuar informacioni i kërkuar, Komisioneri konstaton se, ky i fundit

ka referuar faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhe jo linkun e saktë të saj, ku informacioni i kërkuar të gjendet lehtësisht nga kërkuësja.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuësit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”*. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t’i tregojë ankueses adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuësës çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuësit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

LDI ka për qëllim të nxisë përf forcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së znj. \_\_\_\_\_, nr. 590 Prot., datë 15.03.2023, ndaj Autoritetit Publik “Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Spitali Rajonal

- Shkodër”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 08.02.2023, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (- 1. Sa është sasia vjetore e mbetjeve spitalore? - 2. Sa është fondi në buxhetin tuaj për mbetjet spitalore? - 3. Me cilën apo cilat kompani keni kontrata për mbetjet spitalore? Ju lutem, na i vini në dispozicion. - 4. Sa është vlera financiare e shpenzuar nga 2019-2022 për mbetjet spitalore nga institucioni juaj?), brenda datës 04.5.2023.
  3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallë së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
  4. Ky vendim u shpall sot në datë 26.4.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**